



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 17

Tiranë – E hënë, 6 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9987, datë 25.1.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1647
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 253, datë 17.1.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 7, datë 15.6.2012, “Për kontrollin e mjeteve të transportit në regjim të temperaturave të kontrolluara, sipas marrëveshjes ATP” 1647
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 328, datë 20.1.2017	Mbi rregullat e hollësishme për listën e të dhënave që mbahen në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij..... 1647
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën e organizuar të energjisë elektrike”..... 1652
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 19.1.2017	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike..... 1653
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 3, datë 19.1.2017	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike..... 1653
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 19.1.2017	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike..... 1654
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve” 1654
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” 1655

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 19.1.2017	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s.....	1655
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.....	1656
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 19.1.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “A-V Compass Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1657
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1657
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 12, datë 19.1.2017	Për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tuç”, me fuqi 4470 kW dhe HEC “Lumzi”, me fuqi 11000 kW, me fuqi totale të instaluar 15470 kW.....	1658
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 19.1.2017	Për licencimin e shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1659
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp Energi” sh.p.k., me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 94, datë 6.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”.....	1659
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp Energi” sh.p.k., me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit nr. 102, datë 7.11.2014, “Për tregtimin e energjisë elektrike”.....	1660
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 19.1.2017	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2016 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.....	1661
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 19.1.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.....	1669
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 1, datë 19.1.2017	Mbi një ndryshim në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për autorizim, i ndryshuar.....	1669
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 484, datë 24.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës rreth ‘Qytezës së Fëmijëve’ Korçë”.....	1671

**DEKRET**

Nr. 9987, datë 25.1.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hülya Mahmut Ertaş
2. Vito Bruno Giustino Fiorentino
3. Yusuf Isa Atli
4. Soner Hasan Can
5. Ahmet Safi Murtaza Kayhan
6. Qemajl Shefki Aliu
7. Shkëlzen Shaqir Maliqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bujar Nishani**UDHËZIM**

Nr. 253, datë 17.1.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 7, DATË 15.6.2012 “PËR
KONTROLLIN E MJETEVE TË
TRANSPORTIT NË REGJIM TË
TEMPERATURAVE TË
KONTROLLUARA, SIPAS
MARRËVESHJES ATP”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9289, datë 7.10.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen “Për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mjetet e veçanta, që përdoren në këto transporte”, të ndryshuar, nenit 50, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 7, datë 15.6.2012, “Për kontrollin e mjeteve të transportit në regjim të temperaturave të kontrolluara, sipas marrëveshjes ATP”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Pikat 1.2.b, 8, 17.1 dhe lidhja 2 shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS**
Sokol Dervishaj

UDHËZIM

Nr. 328, datë 20.1.2017

**MBI RREGULLAT E HOLLËSISHME
PËR LISTËN E TË DHËNAVE QË
MBAHEN NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK KOMBËTAR TË
TRANSPORTIT RRUGOR, SI DHE
MODALITETET E MBAJTJES SË TIJ**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 77/1, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, kapitullit IV të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për listën e të dhënave që mbahen në regjistrin elektronik kombëtar, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Zbatimi

Ky udhëzim do të zbatohet për të gjitha subjektet e transportit rrugor të vendosura në



Shqipëri, drejtuesit e veprimtarisë së transportit, drejtuesit e mjeteve, licencat dhe dokumentet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për këto subjekte.

Neni 3 Përkufizime

“Regjistri Elektronik Kombëtar” (REK) është regjistri ku janë të regjistruar të dhënat për subjektet e transportit rrugor, të licencuara dhe të vendosura në Shqipëri.

“VKM-ja mbi rregullat për pranimin në veprimtarinë e subjektit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve zyrtare të caktuar për këto subjekte” është VKM-ja nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

“Udhëzim për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” është udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016.

KREU II

LISTA E TË DHËNAVE, MODALITETET, TRAJTIMI DHE MBIKËQYRJA E DOKUMENTACIONIT QË MBAHET NË REGJISTRIN ELEKTRONIK KOMBËTAR DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 4 Lista e të dhënave

1. REK, i cili vendoset në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), do të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) emrin dhe formën juridike të subjektit;
- b) adresën e vendosjes së saj;
- c) emrin e drejtuesit të veprimtarisë së transportit, i caktuar në plotësimin e kushteve, për sa i përket reputacionit të mirë dhe kompetencës profesionale dhe emrat e ortakëve të subjektit;
- ç) llojin e licencës për të tretë ose me qira dhe numrin e llojin e mjeteve, të shoqëruar me certifikatat e operimit dhe certifikatën për llogari të vet;
- d) numrin dhe llojin e shkeljeve në dy vitet e fundit, në mënyrë të veçantë ato të përmendura

në pikën 3.1 të kapitullit II, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008;

e) emrin e çdo personi të deklaruar të papërshtatshëm në veprimtarinë e transportit të një subjekti në dy vitet e fundit dhe masat rehabilituese nëse ka.

2. Kërkesat minimale për të dhënat që do të regjistrohen në REK do të vendosen në aneksin 1, të këtij udhëzimi.

3. Për qëllime të shkronjës “e”, DPSHTRR-ja, deri më 31 dhjetor 2018, do të përfshijë në REK vetëm shkeljet më serioze të përcaktuara në aneksin 2, të këtij udhëzimi.

Neni 5

Modalitetet e mbajtjes së dokumentacionit

1. Dokumentacioni do të mbahet, për:

a) subjektet e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, të pajisura me licencë për të tretë ose me qira, shoqëruar me certifikatat përkatëse të mjeteve të vëna në dispozicion për kryerjen e veprimtarisë;

b) subjektet e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, të pajisura me certifikatë për llogari të vet;

c) drejtuesit e veprimtarisë, të cilët zotërojnë një certifikate të kompetencës profesionale, të përfituar në qendrat e trajnimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin dhe/ose të lëshuar nga autoriteti ose organi i autorizuar për këtë qëllim nga shteti anëtar i BE-së.

2. Të dhënat në lidhje me një subjekt, të cilit i është pezulluar ose i është hequr licenca, do të mbahen në REK për një periudhë 2-vjeçare, nga data e pezullimit ose e heqjes së licencës, dhe më pas do të fshihen menjëherë.

3. Të dhënat në lidhje me një drejtues veprimtarie në transportin rrugor, që është deklaruar i papërshtatshëm, do të ngelen në REK, për aq kohë sa reputacioni i mirë i këtij personi nuk është rivendosur sipas pikës 4, kapitulli II, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008. Kur të tilla masa të rehabilitimit ose një masë tjetër, që kanë të njëjtin efekt janë ndërmarrë, të dhënat do të fshihen menjëherë.

4. Të dhënat e hedhura në regjistrë, duhet të shoqërohen me arsyet e heqjes së licencës ose deklarimin e papërshtatshmërisë të drejtuesit të veprimtarisë.



5. Të gjitha të dhënat, që mbahen në REK, duhet të përditësohen në vazhdimësi.

6. Autoriteti i licencimit është i detyruar që pas licencimit të çdo subjekti, të dërgojë të gjitha të dhënat për licencimin ose certifikatën për llogari të vet ose ndryshimet që mund të ndodhin më pas, brenda 7 ditëve pune, te mbajtësi i regjistrit elektronik kombëtar, për subjektin e transportit dhe për çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjektit. (Neni 14, pika 6, shkronja “c”, të udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016.)

Neni 6

Trajtimi dhe mbikëqyrja e të dhënave personale

1. Të dhënat që përmban REK, trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës, të caktuar për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Përpunimi i të dhënave personale bëhet, veçanërisht, në përputhje me këto masa sigurie:

a) aksesimi në të dhënat personale duhet të ushtrohet nga njësi përgjegjëse;

b) çdo veprim i kryer me të dhënat personale duhet të dokumentohet;

c) çdo veprim i kryer për të transmetuar të dhënat personale në organe të tjera, duhet të jetë i dokumentuar dhe i gjurmueshëm;

ç) ndalohet kopjimi, modifikimi, korigjimi, fshirja dhe çdo veprim tjetër i paautorizuar me të dhënat personale gjatë transmetimit të tyre në sisteme ose gjatë transportimit të dosjeve përkatëse;

d) mosfunksionimi i sistemeve në rastet e përpunimit të të dhënave, duhet të jetë i raportuar dhe të dhënat duhet të ruhen dhe të mos cenohen.

2. Të dhënat përkatëse, të përfshira në REK, janë në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, duke funksionuar 24 orë në 7 ditët e

javës dhe do të jenë të aksesueshme për të gjitha autoritetet kompetente, sipas përcaktimeve në aktet ligjore.

Neni 7

Shkëmbimi i informacionit

1. Pas licencimit të subjektit transportues, organi që e ka licencuar atë dërgon informacion te mbajtësi i REK-ut dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

2. Drejtoritë, të cilat mbulojnë transportin dhe qarkullimin rrugor në ministrinë përgjegjëse për transportin dhe DPSHTRR-ja, janë pika kontakti për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me shtetet e tjera, në lidhje me subjektet e transportit rrugor të vendosura në Shqipëri, në zbatim të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008.

3. Në rastin kur një operator transporti rrugor jorezident, që ka kryer shkelje, serioziteti i të cilave çon në heqjen e licencës në zbatim të këtij vendimi, pikat e kontaktit, sipas pikës 2 të këtij neni, do t'u komunikojnë autoriteteve përgjegjëse të shtetit tjetër, të regjistrimit të operatorit të transportit rrugor, të gjithë informacionin që zotërojnë, si edhe për shkeljet dhe masat ndëshkimore që janë marrë ndaj tij, të cilat së bashku do të regjistrohen në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të këtij udhëzimi.

KREU III

Neni 8

DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj



ANEKSI 1

KATEGORIA E TË DHËNAVE	TË DHËNAT E SUBJEKTIT	PËRSHKRIM I MËTEJSHËM I FUSHËS SË TË DHËNAVE	GJATËSIA
Subjekti i transportit	Emri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 100
	Forma ligjore	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 50
Adresa	Adresa	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 150
	Kodi postal	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 10
	Qyteti	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 50
	Kodi i vendit	Zgjedhur nga dy shkronja Kodi ISO 3166 – 1 alfa 2	2
Licenca	Tipi	Deklarata e: - “Licencë për transport ndërkombëtar udhëtarësh” - “Licencë për transport udhëtarësh brenda vendit” ose: - “Licencë për transportin ndërkombëtar të mallrave” - “Licencë për transportin e mallrave brenda vendit”	1 – 50
	Numri i serisë së licencës	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 20
	Data e fillimit të licencës	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY - MM-DD)	10
	Data e skadimit të licencës	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY – MM - DD)	10
	Numri i automjeteve të mbuluara	Fushë pa tekst - numerike	1 - 4
	Numrin i automjeteve të regjistruara (*)	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 15
	Statusi i licencës	Deklarata e: - “Aktive” - “Skualifikuar” - “Tërhequr” - “Skaduar” - “Humbur/vjedhur” - “Anuluar” - “Kthyer”	1 - 20
	Data e tërheqjes së licencës	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY - MM - DD)	10
	Data e pezullimit të licencës	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY – MM - DD)	10
	Data e skadimit të pezullimit të licencës	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY – MM - DD)	10
	Arsyeja për pezullimin apo tërheqjen e licencës	Deklarata e: - “Nuk ka ndërmarrje efektive dhe të qëndrueshme” - “Nuk ka gjendje të përshtatshme financiare” - “Nuk ka kompetenca të nevojshme profesionale” - “Jo reputacion të mire” - “Të tjera”	1 - 100
	Numri i serisë i kopjes së vërtetë të licencës të siguruar	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 20
	Data e tërheqjes së kopjes së vërtetë të siguruar	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM-DD)	10
	Data e skadimit të tërheqjes së kopjes së siguruar	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM-DD)	10
Përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes (kur është e nevojshme) (**)	Emri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 100
	Mbiemri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 100
	Datëlindja	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM-DD)	10
	Vendlindja	Tekst i lirë alfa	1-50
Drejtuesi i	Emri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 100



veprimtarisë	Mbiemri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1 - 100
	Datëlindja	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM-DD)	10
	Vendlindja	Tekst i lirë alfa	1-50
	Numri i certifikatës së kompetencës profesionale	Fushë pa tekst alfa-numerike	1-20
	Data e lëshimit të certifikatës së kompetencës profesionale	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM-DD)	10
	Vendi i lëshimit të certifikatës së kompetencës profesionale	Zgjedhur nga dy shkronja Kodi ISO 3166 – 1 alfa 2	2
Shkeljet serioze	Kategoria	Fushe alfa-numerike duke përdorur vlerat e koduara	
	Tipi	Fushe alfa-numerike duke përdorur vlerat e koduara	
	Data e shkeljes	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY – MM - DD)	10
	Data kur është zbuluar shkelja e bërë	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY – MM - DD)	10
	Shteti anëtar ku është konstatuar shkelja	Zgjedhur nga dy shkronja Kodi ISO 3166 – 1 alfa 2	2
	Arsyeja pse humbja e reputacion të mirë është një përgjigje disproporcionale	Fushë pa tekst alfa-numerike	1-500
Person i papërshtatshëm	Emri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1-100
	Mbiemri	Fushë pa tekst alfa-numerike	1-100
	Datëlindja	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM - DD)	10
	Vendlindja	Tekst i lirë alfa	1-50
	Numri i certifikatës së kompetencës profesionale	Fushë pa tekst alfa-numerike	1-20
	Data e lëshimit të certifikatës së kompetencës profesionale	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY- MM - DD)	10
	Vendi i lëshimit të certifikatës së kompetencës profesionale	Zgjedhur nga dy shkronja Kodi ISO 3166 – 1 alfa 2	2
	Arsyeja e deklaramit të paaftësisë	Deklarata e ose: - “Shkelja e rregullave kombëtare” - “Shkelja e rregullave të Komunitetit”	1-100
	Masa aktuale rehabilitimi	Deklarata e ose: - “Trajnimi përsëritur” - “Trajnimi shtesë” - “Rilicencimi” - “Kushte të tjera për licencë” - “Të tjera”	1-100
	Data e fillimit të deklaramit të papërshtatshëm	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY - MM - DD)	10
	Data e fundit të deklaramit të papërshtatshëm	Hyrja e të dhënave numerike në ISO 8601 format (YYYY - MM - DD)	10

(*) Kjo nuk është e detyrueshme për të regjistruar të dhënat në lidhje me numrat e regjistrimit të automjeteve.

(**) Shih nenin 16 (2), (c), regjistri elektronik kombëtar, të Rregullores (KE) nr. 1071/2009.

(***) Nuk ka të dhëna personale të ndryshme nga të dhënat e nevojshme në lidhje me drejtuesin e veprimtarisë, që do të përfshihet në këtë fushë.



ANEKSI 2
SHKELJET MË SERIOZE
për qëllimet e pikës 2, të nenit 4

1. Në lidhje me kohën e drejtimit dhe periudhës së pushimit të drejtuesit të mjetit:

a) tejkalon maksimum 6 ditë pune ose prej një marzh 25% ose më shumë;

b) tejkalon, gjatë periudhës ditore të punës, maksimumin e limitit të kohës ditore të drejtimit prej një marzhi 50% ose më shumë pa marrë një pushim/ndërprerje ose pa një periudhë pushimi pandërprerë të paktën 4,5 orë;

c) nuk ka një tahograf dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë, ose duke përdorur një pajisje të modifikuar e aftë të ndryshojë/të ndërhyjë në regjistrimet e pajisjes regjistruese dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë ose fletën e regjistrimit të falsifikuar ose të dhëna të ngarkuara/transferuar nga tahografi dhe/ose kartës së drejtuesit të mjetit.

2. Në lidhje me dokumentet e udhëtimit:

a) drejton mjetin pa pasur një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik dhe /ose me një defekt serioz, ndër të tjera sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit, gomat etj., që mund të krijojnë një rrezik të menjëhershëm për sigurinë rrugore;

b) transporton mallra që janë të ndaluara për transport ose transporton mallra të tilla në mënyrë të ndaluar ose të paaprovuar ose pa identifikuar ato në mjet, duke rrezikuar jetën e udhëtarëve ose mjedisin;

c) transporton udhëtarë pa pasur leje drejtimi të vlefshme ose transporti kryhet nga një subjekt transporti pa pasur një licencë/certifikatë/autorizim të vlefshëm;

d) drejton mjetin me një dokument të drejtuesit të mjetit të falsifikuar, ose me një dokument të një drejtuesi, i cili nuk është mbajtësi i saj, ose që ka qenë mbajtur mbi bazën e një deklarimi fals dhe/ose dokument të imituar;

e) transporton mallra që kalojnë maksimumin e peshës së lejuar me ngarkesë deri në 20% ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkesën e të cilëve kalon 12 tonët dhe 25% ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkesën e të cilëve nuk kalon 12 tonë.

VENDIM
Nr. 1, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE MARRËVESHJES SË PJESËMARRJES NË BURSËN E ORGANIZUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 19 germa “a” dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” dhe “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në bazë të nenit 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”: “ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e tregut të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, është vendosur “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”;

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e saj nr. 7565, prot., datë 12.12.2016, paraqiti në ERE për miratim draftin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” dhe draftin e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e:

a) “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”



- Specifikimi i Produkteve – shtojca I;
- Rregullat e Tregut Shqiptare të Ditës në Avancë – shtojca II;
- Rregullat e Tregut brenda Ditës – shtojca III;
- Rregullat e Administrimit të Tregut – shtojca IV;
- Rregullat për Pagesat dhe Faturimin – shtojca V;
- Zona e Import/Eksportit – shtojca VI;
- Termat e përgjithshëm VII.

b) “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., MEI-n, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 2, datë 19.1.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR PJESËMARRJEN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit II, pika II.2.4 të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.139, datë 25.8.2016, dhe nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftmarrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi se:

- Kjo Marrëveshje hartohet në zbatim të kapitullit II, pika II.2.4, të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendim të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016.

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Draftmarrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftmarrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. KESH sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetin e Konkurrencës, MEI-n dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 3, datë 19.1.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR GARANCITË FINANCIARE TË PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit III, pika III.2.4, të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016; dhe nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftrregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,



konstatoi se:

- Këto rregulla hartohen nga OST-ja dhe miratohen nga ERE në zbatim të kapitullit III, pika III.2.4 të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016.

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Rregullave për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftrregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI-n, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 4, datë 19.1.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT NË TREGUN E ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitulli III, pika III.1.2 të “Rregullave të përkohshme të tregut Shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016, dhe nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e

draftrregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Kjo rregullore hartohet në zbatim të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendim të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016, kapitulli III, pika III.1.2

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e rregullores “Për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullores “Për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI-n, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 5, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET NR. 140, DATË 22.11.2013 DHE NR. 61, DATË 7.7.2014 “MBI RREGULLAT PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e



drejtorive teknike në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, e cila miratohet nga ERE në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- OST sh.a., me shkresën nr. 7166 prot., datë 16.11.2016, ka dërguar në ERE propozimin për disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet OST sh.a., MEI dhe Autoriteti i Konkurrencës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 6, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT E HEQJES SË LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 7, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 27, pika 7, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe

26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike për rregulloren “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 7, datë 19.1.2017

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLAT E PËRKOHSHME TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 139, DATË 15.8.2016 TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “a”; dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me disa ndryshime në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”,



konstatoi se:

- Në nenin 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut dhe miratohen nga ERE pas propozimit të OST sh.a.

- ERE, me vendimin nr. 151, datë 30.9.2016, pika 2 e tij, filloi procedurat për rishikimin e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 705 prot., datë 5.10.2016, ERE ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me pikat e propozuara për rishikimin e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, pranë subjekteve: MEI, KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetit të Konkurrencës, AAES, FIAA, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël, AREA, si dhe Energji Ashta sh.p.k.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën e saj nr. 8286/1 prot., datë 14.11.2016 ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me vendimin nr. 151, datë 30.9.2016, “Mbi rishikimin e rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.

- ERE, në datën 20.12.2016, zhvilloi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të OST sh.a. dhe KESH sh.a., për të diskutuar në lidhje me qëndrimin e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.8.2016, si më poshtë:

- Kapitulli II, në pikën II.2.2, paragrafi “viii”; - OST-ja, në funksionin e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit do të ketë të drejtën për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të transmetimit nga tregtarët”, - hiqet “nga tregtarët”.

- Në kapitullin V “Kontratat dhe tarifat mes pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të parregulluar janë:” - hiqet fjala “tarifa”, shtohet “të parregulluar”.

- Në kapitullin V, paragrafin “vi” “Rregullat për kontratat dypalëshe”, në pikën V.l - vi)

kontratat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.” - shtohet “dhe shërbimeve ndihmëse”.

- Në kapitullin III, të pikës III.2, paragrafi iv, - një kopje të bilancit të fundit vjetor të certifikuar nga organet e tatimtaksave - bëhet “një kopje të certifikuar të bilancit të fundit vjetor dhe të depozituar në organet e tatimtaksave”.

- Në kapitullin VIII.2.2 - ERE do të miratojë çmimet e rregulluara për njësitë e gjenerimit të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik - shtohet “deri në krijimin e tregut të balancimit ose kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera të ERE”.

- Në kapitullin VIII.3, paragrafi ii – nga “tarifat e mundshme të importit dhe eksportit ose energjisë gjatë dimrit në avancë” – bëhet “Çmimet e mundshme të energjisë në treg gjatë dimrit në avancë/dimrit pasardhës”.

- Në pikën XIV.4.2, të Rregullave, zëvendësohet termi “Furnizues Publik me Shumicë” me “Furnizuesi i Shërbimit Universal”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 8, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E AKSESIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 16, pika 7; 32, pika 1; dhe 63, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij



të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike për udhëzimin mbi “Kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e udhëzimit mbi “Kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 10, datë 19.1.2017

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A-V COMPASS POWER” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, germa “e”; 8 dhe 10; pikat 1, 2, 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për aplikimin për licencim të shoqërisë “A-V Compass Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “A-V Compass Power” sh.p.k., nuk plotëson tërësisht kërkesat e

parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte (neni 9, pika 2, gjerat “d” dhe “e”) nuk janë plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) nuk është plotësuar;

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) nuk janë plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “A-V Compass Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 11, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALCAN ENERGY TRADE” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të



rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pikat 4/8, gjerat “a”, “c” dhe “d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pikat 4/8, gjerat “b”) do të njoftohet aplikuesi që t’i paraqesë në ERE brenda afateve ligjore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 12, datë 19.1.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C INERTE LUMZI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUÇ”, ME FUQI 4470 kW DHE HEC “LUMZI”, ME FUQI 11000 kW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 15470 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Tuç” dhe “Lumzi”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tuç”, me fuqi 4470 kW dhe HEC “Lumzi”, me fuqi 11000 kW, me fuqi totale të instaluar 15470 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 13, datë 19.1.2017

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MC INERTE LUMZI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5, germa “e”; 13 dhe 21, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 14, datë 19.1.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SHPK,
ME NUMËR 248, SERIA PV14K,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE NR.94, DATË
6.10.2014, PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“HURDHAS 1”, “HURDHAS 2”
DHE “HURDHAS 3”**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b” dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të



hidrocentralit “Vinjoll”; neneve 10 dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 8, të kontratës koncesionare nr. 2807 rep., dhe nr. 371 kol., datë 1.9.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2”, me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3”, me fuqi 1,2 MW, për një afat 30-vjeçar, me licencën nr. 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014.

- Me shkresën nr. 791 prot., datë 11.11.2016, koncensionari “Komp Energji” sh.p.k., ka kërkuar zëvendësimin e emrit të koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k., që mban tashmë licencën e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2”, “Hurdhas 3”, me nr. 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, me emrin e shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

- Referuar kërkesës nr. 791 prot., datë 11.11.2016, të koncensionarit, si dhe aplikimit të po kësaj shoqërie për licencim, kërkesa të cilat nuk vijnë në pajtim me njëra-tjetrën dhe frymën e ligjit për koncensionet, tregojnë se veprimet e shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., në cilësinë e Koncensionarit, për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, janë veprime jokorrekte, të cilat kanë sjellë paqartësi gjatë procedurës së licencimit, për rrjedhojë, del e nevojshme të bëhet modifikimi i licencës në favor të shoqërisë koncesionare “Hidropower-plant Construction” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, të mbajtur nga koncesionari “Komp Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 15, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SHPK, ME NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT NR. 102, DATË 7.11.2014, “PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b”; dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; neneve 10 dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së



Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar, me licencën numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.102, datë 7.11.2014.

- Referuar shkresës nr. 791 prot., datë 11.11.2016, të nënshkruar nga administratori i koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k. dhe administratori i shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. është kërkuar zëvendësimi i emrit të koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k., me emrin e shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., vetëm për licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Meqenëse licenca e tregtimit të energjisë elektrike është e lidhur kryesisht me aktivitetin e prodhimit të HEC-ve “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, është e nevojshme të bëhet edhe modifikimi i licencës të tregtimit të energjisë elektrike në favor të shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 7.11.2014, për tregtimin e energjisë elektrike, të mbajtur nga koncensionari “Komp Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 16, datë 19.1.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2016 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 17, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2016 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit mbështetur mbi të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar,

konstatoi se:

1. Rezultojnë 271 të licencuar nga ERE deri në datën 21.11.2016, të cilët janë subjekt i pagesave të rregullimit sipas klasifikimit në vijim:

- licenca prodhimi – 115;

- licenca për ndërtim, instalim dhe prodhim – 10;

- licenca transmetimi të energjisë elektrike/gazit natyror – 2;

- licenca për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror – 2;

- licenca furnizim të energjisë elektrike/gazit natyror – 41;

- licenca për tregtim të energjisë elektrike/gazit natyror – 101.

2. Të ardhura të rregulluara për efekt të llogaritjes së tarifave të rregullimit do të konsiderohen:

a) për kompanitë e prodhimit të energjisë elektrike - të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar;

b) për kompanitë e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike/gazit natyror - të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i transmetimit dhe i shpërndarjes së energjisë apo gazit natyror;

c) për kompanitë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike/gazit natyror - të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shitblerja e energjisë elektrike/gazit natyror.

3. Vërehet se vazhdon të ketë problematika në mosdërgimin e pasqyrave financiare, ndërkohë që një pjesë e pasqyrave financiare të paraqitura janë të



pashoqëruara me raportin e auditit sikurse e kërkon edhe ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Subjektet e licencuara për aktivitetet e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, në pasqyrat financiare të konsoliduara, nuk japin informacion për aktivitetin tregtar dhe për shumicën e të licencuarve rezulton të jetë zero.

5. Me gjithë problematikat e përmendura më sipër, informacioni i grumbulluar nga kompanitë, përgjithësisht konsiderohet i vlefshëm për përlllogaritjet e pagesave të rregullimit duke ruajtur të drejtën për korrigjime, e më pas mund të procedohet deri në penalizim të subjekteve për informacion të padërguar apo të pasaktë, bazuar në nenin 107, pika b, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6. Janë gjithsej 36 të licencuar që nuk kanë paraqitur pasqyrat financiare në ERE dhe as informacion në lidhje me aktivitetin e licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesat e rregullimit për vitin 2016 sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Drejtoria e Administrim Financës dhe Burimeve Njerëzore të njoftojë të licencuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Nr.	Licensa per prodhim	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	"Albanian Green Energy" shpk	358,600	350,129
2	"Balkan Green Energy" shpk	573,200	543,541
3	"EMIKEL 2003" sh.p.k	40,400	51,943
4	"Amal" sh.p.k	16,700	35,648
5	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	75,900	113,854
6	"Wonder power" sha	71,100	95,227
7	"Heci Tervolit" shpk	423,600	391,742
8	"HIDROALBANIA Energji" shpk	185,500	198,543
9	"HEC Bishnica 1,2 "shpk	133,100	135,102
10	"Dishnica Energy" shpk	6,200	21,775
11	"Elektro Lubonje" shpk	3,000	18,432
12	"Selca Energji" shpk	24,300	37,309
13	"Projeksion Energji" sh.a.	15,000	16,298
14	"Sarolli" sh.p.k	15,000	29,263
15	"Juana" sh.p.k	3,500	25,353
16	"WTS Energji" shpk	12,000	22,933
17	"Marjakaj" shpk	15,000	27,852
18	"Maksi Elektrik" sh.p.k	9,400	22,106
19	"Favina 1" shpk	115,700	134,138
20	"EN-KU" sh.p.k	500	15,528
21	"Hidroinvest 1" shpk	264,800	248,758
22	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	15,000	15,000
23	"Malido-Energji" shpk	40,800	45,480
24	"Termocentrali Vlore" sha	20,000	20,000
25	KESH sh.a.	21,253,400	26,436,242
26	"Teodori 2003" shpk	15,000	15,000
27	"Energji Ashta" shpk	2,240,000	2,694,028
28	"Power Elektrik Slabinje" shpk	412,700	335,752
29	"C & S Construction Energy" shpk	426,100	376,914
30	"Hydro Energy "shpk	141,600	186,729
31	"Wenerg " shpk	187,800	112,515
32	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk	134,200	148,627
33	"Ansara Koncension" shpk	3,100	17,711
34	"Energy Plus" shpk	428,600	395,056
35	"Hec Vlushe " shpk	85,800	207,950
36	"Energy partners AP" shpk	210,100	176,544
37	"Hec Dunice" shpk	15,000	15,000
38	"Korkis 2009" shpk	2,700	15,550
39	"Ferfar Energy " shpk	15,000	15,000
40	"Hec-i Dragoshtunje" shpk	15,000	15,000
41	"HP OSTROVICA" shpk	213,900	196,424
42	"Hidropower Elektrik" shpk	15,000	15,000
43	"DN & NAT Energy" shpk	18,000	30,564
44	"Selishte" shpk	75,500	74,826
45	"Idro Energia Pulita" shpk	29,700	76,126
46	"Bekim Energjitik" shpk	42,600	53,966
47	"Erald Energjitik" shpk	18,000	30,597
48	"ERMA MP" shpk	43,600	56,113
49	"Dosku Energy" shpk	33,000	40,492
50	"DITEKO" shpk	15,000	89,893



Nr.	Licensa per prodhim	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
51	"Hec Lanabregas" sha	276,200	341,364
52	"Kurum International" sh.a.	2,679,600	3,701,867
53	"Hydro Salillari Energy" shpk	15,000	15,000
54	"Peshku Picar 1" shpk	6,300	20,246
55	"Albanian Power" shpk	249,400	244,075
56	"Hydro power Plant Of Korca" shpk	158,900	134,622
57	"Henz Energji" shpk	15,000	15,000
58	"Hydro Borshi" sh.p.k	144,100	125,728
59	"Lu & Co Eco Energy" shpk	9,900	23,250
60	"Energo – Sas" shpk	353,700	276,159
61	"Snow Energy" shpk	69,900	69,482
62	"Stravaj Energji" shpk	15,000	94,810
63	"Gjo Spa Power" shpk	524,500	430,236
64	"Erdat Lura" shpk	522,300	424,100
65	"E.T.H.H." shpk	7,000	40,614
66	"Rej Energji" shpk	15,000	15,000
67	"SA-GLE Kompani" shpk	27,800	32,773
68	"Caushi Energji" shpk	23,800	35,464
69	"Energji Xhaq" shpk	10,300	25,787
70	"DUKA T2" shpk	15,000	15,000
71	"Tucep" shpk	11,600	25,257
72	"TRUEN" shpk	15,000	15,000
73	"Hec-Treske" shpk	15,000	78,341
74	"Hidro Energy Sotire" shpk	56,300	68,722
75	"Shutina energji" shpk	15,000	23,786
76	"Hec Cangonj" shpk	15,000	15,000
77	"Zall Herr Energji 2011" shpk	23,400	55,884
78	"Hec Qarr & Kaltanj" shpk	44,400	69,939
79	"Bardhgjana" shpk	15,000	15,000
80	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	33,100	100,757
81	"MTC Energy" shpk	32,600	94,768
82	"EN Rel Hydro" shpk	15,000	15,000
83	"Gurshpat Energy" shpk	5,800	75,353
84	"Bistrica 3 Energy" shpk	15,000	37,212
85	"Gjure Rec" shpk	15,000	15,000
86	"SA'GA-MAT" shpk	15,000	15,000
87	"Komp Energji" shpk	15,000	44,476
88	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)	15,000	15,000
89	"Fatlum" shpk	15,000	17,186
90	"Ayen As Energji" sha	30,000	236,394
91	"Koxherri Energji" shpk	15,000	15,000
92	"Euron Energy" shpk	574,930	413,435
93	"Alb-Energy" shpk	736,878	811,870
94	"Energal" shpk	263,892	15,000
95	"Kisi-Bio-Energji" shpk	15,000	31,276
96	"Gama Energy" sh.p.k.	15,000	15,000
97	"Hec Kabash Porocan" shpk	15,000	15,000
98	"Lengarica & Energy" shpk	15,000	30,476
99	"Mesopotam Energy" shpk	15,000	18,197
100	"Denas Power"		15,000



Nr.	Licensa per prodhim	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
101	"Strelca Energy" shpk		18,531
102	"HP Ujaniku Energy" shpk		15,000
103	"C & S Energy" shpk		15,000
104	"Nishova Energy" shpk		15,000
105	Perparimi SK shpk		15,000
106	Dragobia Energy shpk		15,000
107	Ballenja Power Martanesh shpk		15,000
108	Hec Lashkiza shpk		15,000
109	Liria Energji shpk		15,000
110	Devoll Hydropower sha		15,000
111	Reka Energy shpk		15,000
112	Gavran Energy shpk		15,000
113	Prell Energy shpk		15,000
114	XHENGO ENERGI sh.p.k		15,000
115	DAAB ENERGY GROUP SH.P.K.		15,000
	Total I	35,750,300	43,166,008
II	License per ndertim, instalim dhe prodhim	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	"Muso HEC Qyteze" shpk	15,000	15,000
2	"Remi" shpk	15,000	15,000
3	"Ers-08" shpk	15,000	15,000
4	"E-Vento srl Albania" shpk	30,000	30,000
5	"Albanian Green Energy" shpk	30,000	30,000
6	"Hera" shpk	30,000	30,000
7	"Union Eolica Albania" shpk	30,000	30,000
8	"Alb Wind Energy" shpk	30,000	30,000
9	"Biopower Green Energy" shpk	30,000	30,000
10	"Enpower Albania" shpk	30,000	30,000
	Total II	255,000	255,000
III	Transmetim Energji elektrike/Gazit Natyror	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	OST sh.a	9,290,800	8,350,439
2	Albpetrol sh.a. (Gaz Natyror)	30,000	30,000
	Total III	9,320,800	8,380,439
IV	License per shperndarje te energjise elektrike/gazit natyror	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	"OSHEE" sha	43,471,800	56,430,060
2	"Albpetrol" sh.a. (Gaz Natyror)		30,000
	Total IV	43,471,800	56,460,060



V	License per furnizim te energjise elektrike /Gazit Natyror	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	“OSHEE” sha (2 licensa furnizimi)		-
2	"Albpetrol" sh.a. (energji elektrike)	175,200	175,200
3	“GSA”shpk	1,253,100	963,714
4	“GEN-I Tirana” shpk	784,500	477,205
5	“EFT Albania” shpk	454,100	749,362
6	“Energy Supply AI” shpk	300	15,638
7	“Albanian Green Energy”shpk	15,000	15,000
8	“ Balkan Green Energy”shpk	15,000	15,000
9	“Hydro Salillari Energji”shpk	15,000	15,000
10	"Kurum Energy Resources" sh.a.	15,000	15,000
11	"Kurum international" sh.a 2 licencat	15,000	15,000
12	“Energji Ashta”shpk	15,000	15,000
13	“YLLIAD”shpk	60,800	78,680
14	“Seament Albania”shpk	15,000	15,000
15	“Favina 1”shpk	15,000	15,000
16	“Wonder ” sha	600	15,000
17	“Alpiq Energy Albania” shpk	15,000	15,000
18	“AXPO Albania” sha	16,300	22,675
19	“ERMA MP” sh.p.k	15,000	15,000
20	SNOW ENERGY sh.p.k	15,000	15,000
21	"AYEN Energy Trading" sh.a.	8,100	15,000
22	"Danske Commodities Albania"shpk	15,000	15,000
23	"Ayen As Energji" sha	15,000	15,000
24	"A&A GROUP" shpk	15,000	15,000
25	"Noa Energy Trade" shpk	15,000	15,000
26	"Power Elektrik Sllabinje"shpk	15,000	15,000
27	"Hidropower Elektrik "shpk	15,000	15,000
28	"Future Energy AL"shpk	15,000	15,000
29	"Devoll Hydropower" sha	15,000	15,000
30	"Albanian Energy Supplier" shpk	15,000	15,000
31	"Roberto Oil" sha	15,000	15,000
32	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" shpk	15,000	15,000
33	"Electral" shpk	15,000	15,000
34	"Lengarica & Energy" shpk	15,000	15,000
35	Energjia D O O Veternikshpk		15,000
36	Le Trading Albania shpk		15,000
37	Dragobia Energy shpk		15,000
38	Ballenja Power Martanesh shpk		15,000
39	AE Distribution shpk		15,000
40	"Phoenix Petroleum" sha (Gaz Natyror)		15,000
41	XHENGO ENERGJI sh.p.k		15,000
	Total V	3,128,000	2,977,473



VI	License per tregtim Energjie elektrike /Gaz Natyror	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e rregullimit 2016 (leke)
1	"GSA" shpk	-	-
2	"Gen – I Tirana" shpk	-	-
3	"Enpower Albania" sha	15,000	15,000
4	KESH sh.a.	-	-
5	"Wonder Power" sha	15,000	15,000
6	"EFT Albania" shpk	-	-
7	"Axpo Group" sha	-	-
8	"Alpiq Energy Albania" shpk	15,000	15,000
9	Hydro Energy sh.p.k	15,000	15,000
10	"Energy partners AP" shpk	15,000	15,000
11	"YLLIAD" SHPK	15,000	15,000
12	"ENERGY PLUS" SHPK	15,000	15,000
13	"Energy Supply" shpk	15,000	15,000
14	"Hec Vlushë" shpk	15,000	15,000
15	"Hec Dragoshtunje" shpk	15,000	15,000
16	"Hec Duniçe" shpk	15,000	15,000
17	"Erma MP" shpk	15,000	15,000
18	"Diteko" shpk	15,000	15,000
19	"Albanian Green Energy" shpk	15,000	15,000
20	"Balkan green Energy" shpk	15,000	15,000
21	"Hec Lanabregas" sha	15,000	15,000
22	"Hydro Salillari Energy" shpk	15,000	15,000
23	"Kurum Energy Resources" sh.a.	15,000	15,000
24	"Albpetrol" sha	15,000	15,000
25	"Malido Energji" shpk	15,000	15,000
26	"Albanian Power" shpk	15,000	15,000
27	"SNOW ENERGY" shpk	15,000	15,000
28	"Stravaj Energji" sh.p.k.	15,000	15,000
29	"HP OSTROVICA" shpk	15,000	15,000
30	"BINDI" shpk	15,000	15,000
31	"Energji Ashta" shpk	15,000	15,000
32	"Gjo Spa Power" shpk	15,000	15,000
33	"Erdat Lura" shpk	15,000	15,000
34	"Danske Commodities Albania" shpk	10,700	20,168
35	"EVN Trading" shpk	15,000	15,000
36	"Rej Energji" shpk	15,000	15,000
37	"Seament Albania" shpk	15,000	15,000
38	"Wenerg" sha	15,000	15,000
39	"Henz Energy" shpk	15,000	15,000
40	"A&A GROUP" shpk	15,000	15,000
41	"Favina 1" shpk	15,000	15,000
42	"WONDER" sha	15,000	15,000
43	"TRUEN" shpk	15,000	15,000
44	"A-91" shpk	15,000	15,000
45	"Dans Energy Albania" shpk	400	110,605
46	"Shutina Energji" shpk	15,000	15,000
47	"Zall Herr energy 2011" shpk	15,000	15,000
48	"Gjoka Konstruksion-ENERGY" shpk	15,000	15,000
49	"EN-ERGY" shpk	15,000	15,000
50	"Spahiu Gjanc" shpk	15,000	15,000
51	"MTC Energy" shpk	15,000	15,000
52	"Ayen Energy Trading" sha	15,000	63,089
53	"EN Rel Hydro" shpk	15,000	15,000
54	"Power Wind Energy" shpk	15,000	15,000
55	"Gjurre Rec" shpk	15,000	15,000



VI	License per tregtim Energjie elektrike /Gaz Natyror	Pagesa e Rregullimit 2015 (leke)	Pagesa e Rregullimit 2016 (leke)
56	"Bistrica 3 Energy" shpk	15,000	15,000
57	"Ayen As Energji" sha	15,000	15,000
58	"Power Trade Albania" shpk	15,000	15,000
59	"Albanian General Electricity" sh.a.	15,000	50,739
60	"Antix" shpk	15,000	15,000
61	"Emikel" shpk	15,000	15,000
62	"Komp Energji" shpk	15,000	15,000
63	"SA'GA-MAT" shpk	15,000	15,000
64	"Le Trading Albania" shpk	15,000	15,000
65	Kurum International (2 Licensat e Ulez Shkopet dhe Bistica)	15,000	15,000
66	"Noa Energy Trade" shpk	15,000	25,740
67	"Power Elektrik Sllabinje" shpk	15,000	15,000
68	"Hidropower Elektrik " shpk	15,000	15,000
69	"Fatum" shpk	15,000	15,000
70	"Future Energy AL" shpk	15,000	17,431
71	"Devoll Hydropower" sha	15,000	15,000
72	"Albanian Energy Supplier" shpk	15,000	15,000
73	Roberto Oil sha	15,000	15,000
74	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" shpk	15,000	15,000
75	"Green Energy Trading Albania" shpk	15,000	18,246
76	"Elektral" shpk	15,000	15,000
77	"Koxhemi Energji" shpk	15,000	15,000
78	"Energal" shpk	15,000	15,000
79	"Euron Energy " shpk	15,000	15,000
80	"Hec Kabash Porocan" shpk	15,000	15,000
81	"Gamma Energy" shpk	15,000	15,000
82	"Kisi-Bio-Energji" shpk	15,000	15,000
83	"Lenganica & Energy" shpk	15,000	15,000
84	"Mesopotam Energy " shpk	15,000	15,000
85	"Denas Power" shpk		15,000
86	"HP Ujaniku Energy" shpk		15,000
87	"Energjia D O O Vetemik" shpk		15,000
88	C & S Energy shpk		15,000
89	Nishova Energy shpk		15,000
90	Pepranimi SK shpk		15,000
91	Dragobia Energy shpk		15,000
92	Ballenja Power Martanesh shpk		15,000
93	HecLashkiza shpk		15,000
94	Linia Energji shpk		15,000
95	AE Distribution shpk		15,000
96	NordicInvest Group shpk		15,000
97	"Anio Oil & Gas" shpk (Gaz Natyror)		15,000
98	"Phoenix Petroleum" sha (Gaz Natyror)		15,000
99	Energy Market Albania sh.p.k.		15,000
100	DAAB ENERGY GROUP SH.P.K.		15,000
101	XHENGO ENERGI sh.p.k		15,000
	Total VI	1,226,100	1,641,019
	TOTALI I PAGESAVE TE RREGULLIMIT	93,152,000	112,880,000



VENDIM
Nr. 17, datë 19.1.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E
SË CILËS KONTROLLOHEN
PLOTËSISHT APO PJSËRISHT NGA
SHTETI DHE TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 16; 20/a; 108/3 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “draftmetodologjisë së llogaritjes së tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “draftmetodologjisë së llogaritjes së tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 1, datë 19.1.2017

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
AMA-s NR. 5, DATË 22.5.2013, “MBI
MIRATIMIN E PAGESAVE PËR
AUTORIZIM, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të germës “P”, të pikës 1 dhe pikës 16, të nenit 19, si dhe pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcaktojnë se:

2. Pagesat përcaktohen në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, jodiskriminimit dhe proporcionalitetit”...

Autoriteti i Medias Audiovizive,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1.1.1 “Masa e pagesës vjetore për autorizimin për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve”, të vendimit të pagesave nr. 5, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, i ndryshuar, si më poshtë:

në lekë

Zonat	Deri në 20 programe	Programe nga 21-40	Programe mbi 41
Njësi administrative me popullsi deri 10 000 banorë	80,000	100,000	120,000
Njësi administrative me popullsi deri 20 000 banorë	120,000	150,000	180,000
Njësi administrative me popullsi deri 30 000 banorë	160,000	200,000	240,000
Njësi administrative me popullsi deri 50 000 banorë	280,000	350,000	420,000
Njësi administrative me popullsi deri 70 000 banorë	400,000	500,000	600,000
Njësi administrative me popullsi deri 100 000 banorë	560,000	700,000	840,000
Njësi administrative me popullsi deri 200 000 banorë	800,000	1,000,000	1,200,000
Njësi administrative me popullsi mbi 200 000 banorë	960,000	1,200,000	1,440,000
Bashki me popullsi deri 20 000 banorë	120,000	150,000	180,000
Bashki me popullsi deri 30 000 banorë	160,000	200,000	240,000
Bashki me popullsi deri 50 000 banorë	280,000	350,000	420,000
Bashki me popullsi deri 70 000 banorë	400,000	500,000	600,000
Bashki me popullsi deri 100 000 banorë	560,000	700,000	840,000



Bashki me popullsi deri 200 000 banorë	800,000	1,000,000	1,200,000
Bashki me popullsi mbi 200 000 banorë	960,000	1,200,000	1,440,000
Qark me popullsi deri në 250 000 banorë	800,000	1,000,000	1,200,000
Qark me popullsi deri në 400 000 banorë	960,000	1,200,000	1,440,000
Qark me popullsi mbi 400 000 banorë	1,120,000	1,400,000	1,680,000

2. Ndryshimin e pikës 1.1.2 “Masa e pagesës vjetore për autorizimin për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv”, si më poshtë:

në lekë

Zonat	Pagesa
Njësi administrative me popullsi deri 10 000 banorë	10,000
Njësi administrative me popullsi deri 20 000 banorë	20,000
Njësi administrative me popullsi deri 30 000 banorë	30,000
Njësi administrative me popullsi deri 50 000 banorë	45,000
Njësi administrative me popullsi deri 70 000 banorë	60,000
Njësi administrative me popullsi deri 100 000 banorë	80,000
Njësi administrative me popullsi deri 200 000 banorë	120,000
Njësi administrative me popullsi mbi 200 000 banorë	160,000
Bashki me popullsi deri 20 000 banorë	25,000
Bashki me popullsi deri 30 000 banorë	34,000
Bashki me popullsi deri 50 000 banorë	45,000
Bashki me popullsi deri 70 000 banorë	60,000
Bashki me popullsi deri 100 000 banorë	80,000
Bashki me popullsi deri 200 000 banorë	120,000
Bashki me popullsi mbi 200 000 banorë	160,000
Qark me popullsi deri në 250 000 banorë	200,000
Qark me popullsi deri në 400 000 banorë	400,000
Qark me popullsi mbi 400 000 banorë	500,000

3. Ndryshimin e pikës 2 “Pagesat vjetore për autorizimin për ripërsëritjen e shërbimit të programit audio të mbështetur në rrjete kablore dhe jashtë brezit të frekuencave radiotelevizive”, në ... “Pagesat vjetore për autorizimin për ripërsëritjen e shërbimit të programit audio të mbështetur në rrjete kablore”, si më poshtë:

në lekë

Zonat	Deri në 20 programe	Nga 21 deri në 40 programe	Mbi 41 programe
Njësi administrative me popullsi deri 10 000 banorë	15,000	18,000	21,600
Njësi administrative me popullsi deri 20 000 banorë	16,000	19,200	23,040
Njësi administrative me popullsi deri 30 000 banorë	17,000	20,400	24,480
Njësi administrative me popullsi deri 50 000 banorë	26,000	31,200	37,440
Njësi administrative me popullsi deri 70 000 banorë	28,000	33,600	40,320
Njësi administrative me popullsi deri 100 000 banorë	30,000	36,000	43,200
Njësi administrative me popullsi deri 200 000 banorë	40,000	48,000	57,600
Njësi administrative me popullsi mbi 200 000 banorë	88,000	105,600	126,720
Bashki me popullsi deri 20 000 banorë	22,000	26,400	31,680
Bashki me popullsi deri 30 000 banorë	24,000	28,800	34,560
Bashki me popullsi deri 50 000 banorë	26,000	31,200	37,440
Bashki me popullsi deri 70 000 banorë	28,000	33,600	40,320
Bashki me popullsi deri 100 000 banorë	30,000	36,000	43,200
Bashki me popullsi deri 200 000 banorë	40,000	48,000	57,600
Bashki me popullsi mbi 200 000 banorë	88,000	105,600	126,720
Qark me popullsi deri në 250 000 banorë	30,000	36,000	43,200
Qark me popullsi deri në 400 000 banorë	40,000	48,000	57,600
Qark me popullsi mbi 400 000 banorë	88,000	105,600	126,720



4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gentian Sala

KËRKESË
Nr. 484, datë 24.1.2017
PËR SHPRONËSIM PËR
INTERES PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës rreth ‘Qytezës së Fëmijëve’, Korçë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 72,863,295 (shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA E DETAJUAR E LLOGARITJES SE VLERES SE SHPRONESIMIT

Nr.	Zona Kadastrale	I regjistruar pranë ZVRPP me nr.	Volum	Faqe	Emër Atësi Mbiemër	Statusi Ligjor i pronës sipas ZVRPP Korçë	Parcelë me sipërfaqe (m2)	Ndërtesë (m2)	Shënime	Truall i cili shpronësohet (m2)	Ndërtesë (m2)	Cmimi lekë/m2	Vlera e objektit	Vlera e truallit	Shuma totale e shpronësimit		
1	8561	11/70	25	101	Katerina Tenoqexhi+bpr	Truall	1135		Nuk ka shënime në sektorin D+E	1135		8537		9.689.495	9.689.495		
2	8561	1/874	48	230	Ropi Themistokli Gjika+bpr	Truall	7400		Nuk ka shënime në sektorin D+E	7400		8537		63.173.800	63.173.800		
TOTALI																	
SIPERFAQJA TRUALL SHTET										0	0	0	0				
SIPERFAQJA TRUALL SHTET (PRONAR I PAVERTETUAR)										0	8537						
SIPERFAQJA TRUALL PRIVATE										8535	8537	72.863.295	72.863.295				
SIPERFAQJA NDERTESA PRIVATE															0		
VLERA TOTALE E SHPRONESIMIT															72.863.295		

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë